



РЕПУБЛИКА СРБЕРНА МАКЕДОНИЈА - REPUBLIKA E MAQEDONISE SE VERIUT  
МИНИСТЕРСТВО ЗА ОБРАЗОВАНИЕ И НАУКА  
Биро за развој на образованието  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCES  
Byroja e zhvillimit te arsimit

Бр.Нр. 02-218/3  
31.1. 2022 год./viti  
СКОПЈЕ - ШКУП

Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zvillimit të Arsimit  
Ministry of Education and Science – Bureau for development of education

## UDHËZIME PËR REALIZIMIN E MËSIMIT NË GJYSMËVJETORIN E DYTË NË VITIN SHKOLLOR 2021/2022

Shkup, janar 2022



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit  
Ministry of Education and Science - Bureau for development of education

## PËRMBAJTJA

HYRJA .....	3
UDHËZIME PËR PLANIFIKIMIN DHE REALIZIMIN E MËSIMIT .....	3
1. Planifikimi i mësimit në arsimin fillor dhe të mesëm.....	4
2. Realizimi i mësimit në arsimin fillor dhe të mesëm.....	6
3. Monitorimi, kontrollimi, vlerësimi dhe notimi i arritjeve të nxënësve .....	7
INFORMATA PLOTËSUESE.....	8



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit  
Ministry of Education and Science – Bureau for development of education

## HYRJE

Sipas situatës aktuale epidemiologjike me COVID-19, Qeveria e RMV, më 18 janar 2022 ka marrë vendim për përcaktimin e numrit të ditëve të punës në vitin shkollor 2021/2022, (172 ditë mësimore për shkollat fillore dhe të mesme, përkatësisht 158 ditë mësimore për vitet e fundit të shkollave të mesme). Në bazë të vendimit të Qeverisë dhe ndryshimeve në *Kalendarin për organizimin dhe punën në shkollat fillore në vitin shkollor 2021/2022 dhe Kalendrain për organizimin e vitit shkollor 2021/2022 në shkollat e mesme publike*, Byroja e Zhvillimit të Arsimit ka përgatitur *Udhëzime për zbatimin e mësimin në gjysmën e dytë të vitit shkollor 2021/2022*.

Gjatë organizimit dhe realizimit të mësimin në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021/2022, shkollat fillore dhe të mesme dhe të gjithë faktorët në procesin edukativo-arsimor duhet të respektojnë protokollet nga *Plani për mbajtjen e mësimin në shkollat fillore dhe të mesme në vitin shkollor 2021/2022*.

## UDHËZIME PËR PLANIFIKIMIN DHE REALIZIMIN E MËSIMIN

Duke pasur parasysh numrin e reduktuar të ditëve të mësimin, Byroja e Zhvillimit të Arsimit, në kuadër të kompetencave të saj, jep udhëzime për planifikimin dhe zbatimin e mësimin në gjysmëvjetorin e dytë të vitit shkollor 2021/2022 në përputhje me planprogramet e rregullta.

Në programet mësimore të rregullta, gjegjësisht në planin mësimor, është paraparë numri i orëve për secilën lëndë mësimore - vjetore dhe javore për klasën/vitin përkatës. Me zgjatjen e pushimit dimëror, zvogëlimi i orëve është si më poshtë:



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit  
Ministry of Education and Science -- Bureau for development of education

Numri i përgjithshëm i orëve për lëndën mësimore në vit sipas planit mësimor	Numri i orëve të cilat zvogëlohen në gjysmëvjetorin e dytë
36	1 deri 2
72	2 deri 4
108	3 deri 6
144	4 deri 7
180	8 deri 9
216	8 deri 10

Secila nga lëndët që mësohen sipas planit mësimorë përfaqësohen me një, dy, tre, katër, pesë ose gjashtë orë në javë. Lënda e përfaqësuar me një orë në javë ka një fond vjetor prej 36 orësh dhe reduktimi i saj është 1 deri në 2 orë në gjysmëvjetorin e dytë; lënda mësimore me 2 orë në javë dhe 72 orë në vit do të ketë një reduktim prej 2 deri në 4 orë; lënda mësimore me 3 orë në javë dhe 108 orë në vit do të reduktohet me 3 deri në 6 orë; lënda mësimore me 4 orë në javë dhe 144 orë në vit reduktohet me 4 deri në 7 orë; lënda mësimore me 5 orë në javë dhe 180 orë në vit reduktohet me 8 deri në 9 orë, ndërsa lënda me 6 orë në javë dhe 216 orë në vit reduktohet nga 8 deri në 10 orë varësisht të orarit të mësimiit.

### 1. Planifikimi i mësimiit në arsimin fillor dhe të mesëm

Planifikimi i mësimiit është një proces krijues që përfshin një sërë procedurash dhe aktiviteteve vijuese me qëllim arrijtjen në kohë, cilësore dhe arrijtjen e plotë të qëllimeve të definuara/ rezultateve në mësimnxënie dhe koncepteve të përcaktuara për përmbajtjet e të gjitha temave/fushave/njësive modulare. Planifikimi i mësimiit duhet t'u përshtatet kushteve reale që të realizohet si duhet, d.m.th nënkupton planifikimin e aktiviteteve që



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit  
Ministry of Education and Science – Bureau for development of education

duhet të realizohen para, gjatë dhe pas orës së mësimi, si dhe përgatitjen në kohë të materialeve mësimore dhe didaktike.

Si rezultat i stërzgjatjes së fillimit të gjysmëvjetorit të dytë për shkak të situatës epidemiologjike, planet mësimore po u përshtaten kushteve. Përgatitja e mësimdhënies fokusohet kryesisht në harmonizimin e përmbajtjeve të programit me burimet në dispozicion, zgjedhjen e mjeteve dhe formave të duhura të punës, si dhe organizimin e mësimdhënies. Prandaj, planifikimi për secilën lëndë duhet të bazohet në programin për klasën/vitin përkatës në përputhje me planin e caktuar mësimor.

Secili mësues duhet të bëjë përshtatjet në planifikimin e mësimdhënies për lëndën, duke u udhëhequr nga rezultatet/qëllimet e të nxëniet, përmbajtjet, konceptet, metodat dhe aktivitetet e përcaktuara në programin mësimor. Nëse mësimdhënësit kanë përgatitur planet për gjysmëvjetorin e dytë, është e nevojshme që ato të rishikohen dhe të bëhen ndryshime të përshtatshme (të vogla) sipas numrit të ditëve të mësimi në gjysmëvjetorin e dytë.

Fondin e orëve nga gjysmëvjetori i dytë për përmbajtjet e reja mësimore, përsëritjen, përcaktimin, ushtrimet, kontrollimin e njohurive të nxënësve, sistemimin, kërkimin, realizimin e projekteve etj., mësuesi e shpërndan në varësi të ecurisë dhe nevojave të nxënësve dhe kushteve të punës.

Orët e parashikuara për miratimin e përmbajtjeve të reja mësimore mund të planifikohen të integruara me orë për ushtrime, etj., për të arritur të njëjtin rezultat në një periudhë më të shkurtër kohore. Gjithashtu, përmbajtjet individuale që kanë rezultate/qëllime të përbashkëta mësimore të parashikuara në programin mësimor mund të planifikohen për një orë.

Planifikimi, për të qenë funksional dhe cilësor dhe për të siguruar zbatueshmërinë e njohurive, duhet të përmbajë propozime për integrim, korrelacion të



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit  
Ministry of Education and Science - Bureau for development of education

brendshëm/të jashtëm të përmbajtjeve mësimore përmes aktiviteteve të duhura dhe qasjes së duhur metodologjike. Roli kryesor i integritit, i korrelacionit të brendshëm/të jashtëm ndërmjet përmbajtjeve mësimore është të sigurojë integritetin e njohurive që synohen të realizohen me programin mësimor. Duke vepruar kështu, do të tregohet kujdes që mësimdhënia të shihet si një sistem i integruar dhe lidhës me njëra-tjetrën përmbajtje, koncepte dhe aktivitete (brenda lëndëve të shumta ose brenda vetë lëndës) si dhe për të lidhur të mësuarin me atë që do të mësohet.

## 2. Realizimi i mësimin në arsimin fillor dhe të mesëm

Realizimi i mësimin duhet të jetë në përputhje me planifikimin. Rezultatet/objektivat e të nxënit të përcaktuara në programet mësimore duhet të arrihen plotësisht përmes të gjitha përmbajtjeve të temave/fushave/njësive modulare.

Në mënyrë që programet mësimore të realizohen plotësisht në periudhën e shkurtuar të gjysmëvjetorit të dytë, realizimi i përmbajtjeve të reja mësimore mund të arrihet përmes integritit me ushtrime, realizimit të projekteve etj., dhe përmbajtjeve të veçanta që kanë rezultate/qëllime të përbashkëta mësimore të parashikuara në programin mësimor mund të realizohen në një orë mësimi.

Në procesin e të nxënit dhe mësimdhënies, mësimdhënësi/ja duhet të zbatojë teknika të ndryshme të të nxënit, ndërthurje të metodave dhe formave moderne të mësimdhënies aktive, pavarësisht nëse mësimi realizohet me prani fizike apo është mësim në distancë.

Teknikat e të nxënit aktiv dhe të mësimdhënies inkurajojnë zbatimin efektiv të njohurive dhe aftësive të fituara në identifikimin, përshkrimin, shpjegimin, vërtetimin, zgjidhjen e problemeve dhe zhvillimin e të menduarit kritik.



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës – Byroja e Zhvillimit të Arsimit  
Ministry of Education and Science – Bureau for development of education

Për arritjen e rezultateve/objektivave të të nxënit, rekomandohet aplikimi i mjeteve të ndryshme mësimore të parashikuara në programin mësimor, duke përfshirë mjete ndërvepruese, aplikacione digjitale, platforma edukative, softuer edukativ etj. Prandaj, është e nevojshme që mësimitdhënësi t'i qaset në mënyrë kreative realizimit të përmbajtjeve mësimore për arritjen e rezultateve/qëllimeve mësimore, të cilat do të nxisin dhe motivojnë nxënësit të përvetësojnë dhe zgjerojnë njohuritë dhe aftësitë si dhe zbatueshmërinë e tyre në kontekstin e përditshëm, si dhe të zhvillojnë qëndrimet, vlerat dhe sjelljet.

Realizimi i mësimit duhet të jetë në drejtim të krijimit të kushteve për përparim individual të çdo nxënësi në përputhje me mundësitë, aftësitë dhe interesat e tij, dhe njëkohësisht të krijohet një mjedis krijues frymëzues për mësim dhe punë. Mësimdhënia e diferencuar mund të jetë një nga mënyrat e mësimdhënies dhe të nxënit që korrespondon me nivelet e ndryshme të arritjeve të nxënësve dhe stilet e tyre të të nxënit.

### 3. Monitorimi, kontrollimi, vlerësimi dhe notimi i arritjeve të nxënësve

Gjatë procesit mësimor, mësuesi duhet të monitorojë, kontrollojë, vlerësojë vazhdimisht arritjet e nxënësve në kuadër të orëve të planifikuara për realizimin e mësimdhënies, duke përdorur metoda, teknika dhe instrumente të ndryshme. Vlerësimi duhet të jetë formativ dhe përmbledhës.

Vlerësimi dhe informatat e rregullta duhet të shërbejnë për të përmirësuar mësimdhënien dhe të nxënit. Gjatë orës mësimitdhënësi/ja monitoron dhe vlerëson: përgjigjet me gojë, diskutimet, kontributin në përfundim, fleta pune, fleta mësimore, punët praktike, detyrat e shtëpisë, përgjigje kuize, testet, projekte, zgjidhje problemash etj. Reagimet në kohë dhe konstruktive u mundësojnë



Министерство за образование и наука - Биро за развој на образованието  
Ministria e Arsimit dhe Shkencës - Byroja e Zhvillimit të Arsimit  
Ministry of Education and Science - Bureau for development of education

nxënësve të identifikojnë hapat e ardhshëm të nevojshëm për të çuar përpara  
mësimin e tyre.

### INFORMATA PLOTËSUESE

Udhëzimet e mësipërme përmbajnë informacion në lidhje me planifikimin dhe zbatimin e  
mësimdhënies në gjysëmvetorin e dytë. Për të gjitha konsultimet e tjera të nevojshme dhe  
përgjigjet e pyetjeve që dalin nga puna aktuale, planifikimi dhe zbatimi i programeve për  
gjysmëvetorin e dytë, mësimdhënësit dhe shkollat mund të kontaktojnë Byronë e  
Zhvillimit të Arsimit dhe këshilltarët e mësimin klasor dhe këshilltarët e lëndëve adekuate  
mësimore.

